



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1030 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2022

VENDIM

Nr. 426, datë 24.08.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e rezultatit të sondazheve arkeologjike të realizuar nga subjekti të licencuar Znj. Iris Pojani në kuadër të projektit *“Rehabilitimi i Sheshit të ish-shkollës 8- vjeçare Llambi Goxhomani”*, në kuadër të projektit *“Task 4, Koncepti paraprak udhëzimet dhe preventive paraprak, për projektet e përzgjedhura në Berat”*, zhvillues “FSHZH” dhe zbatues i punimeve “Leon” sh.p.k. dhe “Be - Is” sh.p.k.
2. Mbulimin e sondazheve të gërmuara me qëllim konservimin e strukturave të zbuluara; dhe vijimin e zbatimit të projektit;
3. Gjetjet arkeologjike të depozitohen pranë DRTK Berat;
4. Zbatimi i punimeve për projektin *“Rehabilitimi i Sheshit të ish-shkollës 8- vjeçare Llambi Goxhomani”*, në kuadër të projektit *“Task 4, Koncepti paraprak udhëzimet dhe preventive paraprak, për projektet e përzgjedhura në Berat”*, të mbikëqyret nga specialistët e DRTK Berat, me qëllim mosdëmtimin e rrënojave arkeologjike të zbuluara nga sondazhet;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr.76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri, Tel.: +355 44504152; Email: info@iktk.gov.al; www.iktk.gov.al